



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR
PROCEDURËN E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR
MALLRA¹²**

OBJEKTI

“BLERJE KUTI DHE DOSJE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME”

MARRËVESHJE KUADËR

¹ Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash, Autoriteti /Enti kontraktor do t’i referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

² Seti i Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë hartohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet variantit të setit në gjuhën shqipe me variantin në gjuhën angleze, do të merret për bazë seti në gjuhën shqipe.

NJOFTIME

NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT (Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor;

Emri _____

Adresa _____

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror	Institucioni i pavarur
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njësi e autoriteteve vendore	Të tjera
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta	Organ Qendror blerës	Ofrues shërbimi
<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Publik <input type="checkbox"/> Privat <input type="checkbox"/>
I deleguar		Të tjera
<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>

1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: _____

Tel/faks _____

E-mail _____

1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

1.6 Lloji i procedurës së prokurimit: _____

1.7 Tipi i kontratës: _____

1.8 Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor (në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare):

1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër: _____

1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:

1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:

1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:

1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____

NJOFTIMI I KONTRATËS*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)***Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor****1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri:	Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Adresa:	Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
Tel/Faks:	0696092745
E-mail:	sektori_mallrat@obp.al
Adresa e ueb- faqes:	www.obp.al
Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail)	M.D / R.N sektori_mallrat@obp.al

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror	<input checked="" type="checkbox"/>	Institucioni i pavarur	<input type="checkbox"/>
Njësi e autoriteteve vendore	<input type="checkbox"/>	Të tjera	<input type="checkbox"/>

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta	<input type="checkbox"/>	Organ Qendror blerës	<input checked="" type="checkbox"/>	Ofrues shërbimi	Publik <input type="checkbox"/> Privat <input type="checkbox"/>
I deleguar	<input type="checkbox"/>	Të tjera	<input type="checkbox"/>		

1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po **Jo**

1.5 Kontrate që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:

Po **Jo**

1.6 Kontratë e rezervuar :

Po Jo

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-43560-04-03-2025

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) 22852000-7, 44617000-8

2.3 Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

Blerje	Marrje me qira	Blerje me këste	Një kombinim i tyre
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po Jo

2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:

Me një Operator Ekonomik

Me disa Operatorë Ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po Jo

2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes:

-Në zbatim të nenit 52/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në nenin 64 të VKM- së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet se:

“Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër.

Nëse nevojat e autoritetit/entit kontraktor ndryshojnë, atëherë do të duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatisë ofertën e tij për kontratën bazuar në marrëveshjen kuadër vetëm në lidhje me kushtet, për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.”

-Autoriteti kontraktor do të përdor Marrëveshjen Kuadër për plotësimin e nevojave nisur nga natyra e mallit që do të prokurohet, ku nevojat për këtë mall janë periodike dhe shtrihen gjatë

katër viteve. Është përzgjedhur Marrëveshja Kuadër me 1 Operator Ekonomik pasi malli që do të prokurohet është specifik, kuti dhe dosje me ruajtje të përhershme, sipas tipologjisë së dokumenteve që do të ruhen në to. Autoritetet dhe entet Kontraktore nuk mund të parashikojnë sasinë e saktë të mallit pasi një gjë e tillë del gjatë përpunimit tekniko shkencor të dokumenteve, proces i cili është i vazhdueshëm në institucionet pjesë e Marrëveshjes Kuadër.

- Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër, të tilla si: artikujt, specifikimet e sakta teknike, kushtet e lëvrimit, si dhe sasinë e pritshme të kërkuara. - Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa operatorë ekonomik do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për operatorin ekonomik të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të lëvrimit. - Lidhja e Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik të vetëm, shoqërohet me mirëorganizimin e këtij të fundit, për vetë natyrën e mallrave objekt prokurimi, për sigurimin e mallrave dhe furnizimin në kohën e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

-Me qëllim garantimin e kryerjes së furnizimit në afatet kohore të përcaktuara për Autoritetin Kontraktor përfitues të Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik të vetëm do të garantonte sigurinë e kryerjes së furnizimit sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara, duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

-Në zbatim të nenit 14 pika 1 të VKM-së Nr. 821, datë 26.12.2024 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe të organeve që funksionojnë pranë saj” përcaktohet se: “1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave mbledh nevojat për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, përfshirë edhe etiketat e tyre, dhe ia përcjell ato Operatorit të Blerjeve të Përqendruara sh.a., për prokurimin e përqendruar të tyre. Tarifa e procedurës përballohet nga buxheti i DPA-së.”

2.7 Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 1 operator ekonomik.
(Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

	<p>Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .</p>	<p>Nuk do të ketë rihapje të konkursit.</p> <p>Kontrata / kontratat do të lidhen sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor të përcaktuara në pikën 2.9 të DT, me operatorin ekonomik të suksesshëm për secilin lot.</p> <p>Dhënia e kontratës/ kontratave do të behet nga Autoriteti Kontraktor i përcaktuar në pikën 2.9 të DT.</p>
--	---	--

		<p>Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër. Ne rast te lindjes se nevojës konkrete per te lidhur nje kontrate për secilin lot brenda marrëveshjes kuader, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasi të përkatëse të artikujve.</p> <p>Autoriteti kontraktor i kerkon operatorit ekonomik fitues, te japë oferten e tij.</p> <p>Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe ne çdo rast duhet te dokumentohet dhe te behet pjese e dosjes se procedures.</p> <p>Sasitë e parashikuara dhe të kerkuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato.</p>
--	--	---

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër: *(këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)*

1. SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR me fond limit 99,924 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzetë e katër) lekë pa tvsh;
2. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT me fond limit 44,032 (dyzet e katër mijë e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh;
3. TEATRI KOMBËTAR me fond limit 532,320 (pesëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e njëzetë) lekë pa tvsh;
4. AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE me fond limit 2,333,442 (dy milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e dyzet e dy) lekë me tvsh;
5. HEKURUDHA SHQIPTARE SH.A me fond limit 72,120 (shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzetë)lekë pa tvsh;
6. MINISTERIA E MBROJTJES me fond limit 1,442,400 (një milion e katërqind e dyzetë e dy mijë e katërqind) lekë pa tvsh;
7. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT me fond limit 352,500 (treqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa tvsh;
8. AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE me fond limit 22,300 (njëzetë e dy mijë e treqind) lekë pa tvsh;

9. INSTITUTIT I SIGURIMEVE SHOQERORE me fond limit 934,080 (nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
10. AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMTNTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT me fond limit 2,945,250 (dy milion e nëntëqind e dyzetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh;
11. GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR me fond limit 202,680 (dyqind e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
12. AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL me fond limit 525,720 (pesëqind e njëzetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë pa tvsh;
13. AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË SPORTIT me fond limit 68,842 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dyzetë e dy) lekë pa tvsh;
14. AGJENCIA KOMBËTARE E TURIZMIT me fond limit 502,000 (pesëqindë e dy mijë) lekë pa tvsh;
15. ALBBAKËR SHA me fond limit 76,932 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh;
16. REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 me fond limit 51,452 (pesëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa tvsh;
17. DREJTORIA E PERGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE me fond limit 95,940 (nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë pa tvsh;
18. AGJENCIA SHTETËRORE E PROGRAMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS me fond limit 145,940 (njëqind e dyzetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzetë) lekë pa tvsh;
19. KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT me fond limit 17,943,650 (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh;
20. ALBKROM SH.A me fond limit 76,932 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh;
21. DREJTORIA VENDORE E AGJENCISE SHTETERORE TE KADASTRES ZONAT E STIMULUARA me fond limit 2,502,360 (dy milion e pesëqind e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh;
22. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT me fond limit 347,995 (treqind e dyzetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh;
23. KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK me fond limit 340,545 (treqind e dyzet mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë pa tvsh;
24. AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT me fond limit 539,392 (pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa tvsh;
25. AGJENCIA E PASTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA me fond limit 108,180 (njëqind e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
26. AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE me fond limit 99,924 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh;
27. INSTITUTI I TRANSPORTIT me fond limit 136,045 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e pesë) lekë pa tvsh;
28. AUTORITETI I KONKURRENCËS me fond limit 99,924 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh;
29. INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK me fond limit 773,400 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqindë) lekë pa tvsh;
30. AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS me fond limit 223,000 (dyqind e njëzetë e tre mijë) lekë pa tvsh;

31. AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE me fond limit 418,575 (katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh;
32. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS me fond limit 362,880 (treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
33. REGJIMENTI I OPERACIONEVE SPECIALE, REPARTI USHTARAK NR.1040 me fond limit 582,900 (pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh;
34. INSTITUTI GJEOSHKENCAVE me fond limit 348,245 (treqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë pa tvsh;
35. SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA, KOMANDA E FORCËS AJRORE me fond limit 3,005,085 (tre milion e pesë mijë e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh;
36. MINISTRIA E FINANCAVE, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE-SË, BB-SË DHE DONATORËVE me fond limit 8,310,340 (tetë milion e treqind e dhjetë mijë e treqind e dyzet) lekë pa tvsh;
37. AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMVE UJORE me fond limit 58,360 (pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh;
38. GJYKATA KUSHTETUESE me fond limit 204,500 (dyqind e katër mijë e pesëqindë) lekë pa tvsh.
39. DEGA E THESARIT LUSHNJE me fond limit 22,300 (njëzet e dy mijë e treqindë) lekë pa tvsh;
40. DREJTORIA RAJONALE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE VLORË me fond limit 84,690 (tetëdhjetë e katër mijë e e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh;
41. DREJTORIA RAJONALE E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT SHKODËR me fond limit 291,800(dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqindë) lekë pa tvsh;
42. DEGA E THESARIT KUKËS me fond limit 47,186 (dyzet e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh;
43. DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR SKRAPAR me fond limit 243,880 (dyqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
44. DEGA E THESARIT HAS me fond limit 89,676(tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh;
45. DREJTORIA RAJONALE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE TIRANË me fond limit 99,854 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh;
46. DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR "SHENJTA MARI" MIRDITË me fond limit 333,080 (treqind e tridhjetë e tre mijë e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
47. ZYRA VENDORE ARSIMORE MAT me fond limit 103,000 (njëqind e tre mijë) lekë pa tvsh;
48. BASHKIA PEQIN me fond limit 1,868,170 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh;
49. DEGA E THESARIT POGRADEC me fond limit 74,580 (shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
50. DEGA E THESARIT VLORE me fond limit 50,864 (pesëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh;
51. PORTI DETAR SARANDË me fond limit 1,173,840 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzet) lekë pa tvsh;
52. BASHKIA KRUIË me fond limit 1,963,760 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh;
53. BASHKIA VLORË me fond limit 942,740 (nëntëqind e dyzetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet) lekë pa tvsh;

54. PREFEKTI I QARKUT DIBËR me fond limit 70,032 (shtatëdhjetë mijë e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh;
55. DEGA DOGANORE KUKËS (MORINË) me fond limit 187,220 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëzet) lekë pa tvsh;
56. DREJTORIA VENDORE E POLOCISË ELBASAN me fond limit 1,897,150 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh;
57. PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN me fond limit 1,345,900(një milion e treqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh;
58. DEGA E THESARIT DELVINE me fond limit 94,420(nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet) lekë pa tvsh;
59. BASHKIA DELVINE me fond limit 628,540 (gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë pa tvsh;
60. DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT DURRËS me fond limit 172,915 (njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh;
61. DEGA E THESARIT TROPOJË me fond limit 70,792 (shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa tvsh;
62. NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN me fond limit 58,360 (pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh;
63. DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR KURBIN me fond limit 94,420 (nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet) lekë pa tvsh;
64. BASHKIA KAMËZ me fond limit 316,000 (treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh;
65. SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME SARANDE SH.A me fond limit 223,000(dyqind e njëzet e tre mijë) lekë pa tvsh;
66. DREJTORIA VENDORE E POLICISE BERAT me fond limit 391,610 (treqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa tvsh;
67. ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DEVOLL me fond limit 22,300(dyqind e njëzet e tre mijë) lekë pa tvsh;
68. DREJTORIA RAJONALE E AUTORITETIT KOMBETAR TË USHQIMIT QARKU BERAT me fond limit 99,640(nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa tvsh;
69. DREJTORIA VENDORE ASHK ELBASAN me fond limit 1,047,050 (një milion e dyzet e shtatë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh;
70. ZYRA VENDORE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE BERAT me fond limit 179,710 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë pa tvsh;
71. DEGA E THESARIT KRUIJE me fond limit 41,280 (dyzet e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
72. DEGA E DOGANES SHKODER me fond limit 96,792(nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa tvsh;
73. BASHKIA PERMET me fond limit 199,532 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh;
74. ZYRA VENDORE ARSIMORE DURRËS me fond limit 196,050(njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh;
75. DREJTORIA E SPITALIT "IHSAN ÇABEJ" LUSHNJË me fond limit 465,851(katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa tvsh;
76. DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE BERAT me fond limit 163,849 (njëqind e gjashtë dhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) lekë pa tvsh;
77. UNIVERSITETI "EQEREM ÇABEJ" GJIROKASTËR me fond limit 326,130 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh;

78. BASHKIA TROPOJË me fond limit 288,480 (dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
79. PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR me fond limit 695,250 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh;
80. ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR BULQIZË me fond limit 317,166 (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh;
81. PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR me fond limit 1,039,190 (një milion e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh;
82. DREJTORIA VENDORE E POLICISË FIER me fond limit 716,570 (shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh;
83. BASHKIA KOLONJË me fond limit 645,280 (gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
84. BASHKIA HAS me fond limit 288,480 (dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;
85. DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR TEPELENË me fond limit 109,832 (njëqind e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh;
86. QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK GJIROKASTËR me fond limit 124,030 (njëqind e njëzet e katër mijë e tridhjetë) lekë pa tvsh;
87. ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KRUIË me fond limit 65,478 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh;
88. DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR GRAMSH me fond limit 579,950 (pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh;
89. BASHKIA DEVOLL me fond limit 419,130 (katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh;
90. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR DREJTORIA E RAJONIT VERIOR SHKODËR me fond limit 251,590 (dyqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh;
91. DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT KORÇË me fond limit 175,141 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e një) lekë pa tvsh;
92. ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR MIRDITË me fond limit 55,608 (pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetë) lekë pa tvsh;
93. GJYKATA E SHKALLËS SË PARË JURIDIKSIONI I PËRGJITHSHËM DIBËR me fond limit 5,959,830 (pesë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh.

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1. Fondi limit/vlera e pritshme e marrëveshjes kuadër: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose **748,658.1** (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) Euro pa TVSH Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë.

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është Nuk aplikohet.**

3. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

4. Kodi Output: **1234567**

5. Tipi:

Investime

Kodi: _____

Vlera: _____

Shërbime **X**

Kodi: 602

Vlera: **74,439,074** lekë pa TVSH

748,658.1 Euro pa TVSH

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë; Afati i lëvrimin të mallit është 60 ditë nga lidhja e kontratës.

Ose

Fillon më mbaron më

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Kohëzgjatja në muaj: 48 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

Ose fillon më _____/_____/_____ (d/m/v)

mbaron më _____/_____/_____ (d/m/v)

2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:

Sipas adresave të autoriteteve dhe enteve kontraktore, pjesë e Marrëveshjes Kuadër të përcaktuar në pikën 2.9 të DST.

2.13 Ndarja në Lote:

Po

Jo

X

Në Nenin 42, pikat 1 dhe 2 të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote pasi kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash të furnizimit me kuti dhe dosje me ruajtje të përhershme, sipas tipologjisë së dokumenteve që do të ruhen në to. Pra nga ana teknike dhe organizative është e nevojshme kryerja e furnizimit pa e ndarë procedurën në lote.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- c) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetem paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon konkurrencën, pasi kriteret e hartuara ne DST janë gjithëpërfshirëse, që u jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.

Nëse po,

2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

- një Lot,
- disa Lote,
- të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t’i jepen një ofertuesi _____

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t’i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):

Po **Jo** **X**

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen.

2.15 Pranoen variantet:

Po **Jo** **X**

2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:

Po **Jo** **X**

Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:
(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)

2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:

Po **Jo** **X**

Shënime të tjera (nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po **Jo** **X**

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Nëse operatori ekonomik mbështet në kapacitetet e subjekteve të tjera duhet të zbatojë parashikimet e përcaktuara në nenin 84 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 90 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se se prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës totale është **1.488.781,48** (një milion e katerqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një pikë dyzet e tetë) lekë, ose **14.973,16** (katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro pa TVSH Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

3.1.2 Autoriteti/Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor):

Nr.	Banka	Nr. llogarisë
1	Credins	AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

- i. garancisë bankare
- ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë

Seksioni 4: Procedura

4.1. Lloji i procedurës: E hapur mbi kufirin e lartë monetar

4.2. Është përdorur njoftimi paraprak/periodik i informacionit:

Po Jo

Nëse Po, numri i referencës është _____

4.2.1. Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po Jo

4.3 Procedurë e rishpallur:

Po Jo

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____
- b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____
- c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) ³Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto

Sipas rëndësisë:

çmimi pikët
_____ pikët
_____ pikët
_____ pikët

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

OSE

B) oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e

³ Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: **05/05//2025(d/m/v)** ora **11:00**

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42, pika 6, të LPP (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po **Jo**

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

Anglisht

Seksioni 5: Informacione shtesë:

5.1 Dokumente me pagesë (zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po **Jo**

Nëse po

Monedha _____

Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (kur është e aplikueshme)

Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi

04/04/2025

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrrimit]

FTESË PËR OFERTË

(shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për furnizimin e mallrave në vijim:

.....
.....
.....

jepni një përshkrim të saktë të mallrave dhe sasisë konkrete të kërkuar:

Vendi i dorëzimit të mallrave: (jepni një përshkrim të shkurtër) _____

Koha e dorëzimit/lëvrimit: Mallrat duhet të dorëzohen brenda datës _____

Ofertat duhet të paraqiten në:

.....[jepni adresën e saktë]

Afati i fundit për pranimin e ofertave:

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Forma shkresore

Forma elektronike (e-mail, faks, etj.)

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në
Buletinin e Njoftimeve Publike)

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sha.a
Adresa Rruga "Reshit Çollaku", Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
Tel/Faks 0696092745
E-mail: sektori_mallrat@obp.al
Ueb-faqe www.obp.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", Mall.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: **REF-43560-04-03-2025**

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme", Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar.

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 22852000-7, 44617000-8

6. Fondi limit total i marrëveshjes kuadër është në vlerën 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose **748,658.1** (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) Euro pa TVSH Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: -Afati i marrëveshjes kuadër është 48 (dyzetë e tetë) muaj nga data e nënshkrimit dhe afati i lëvrimin të mallit 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës përkatëse.

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 05.05.2025 (d/m/v) Ora: 11:00

9. Procedurë e Rishpallur:

Po Jo X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma, monedha)

[Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I

KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Mallra: Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër _____		
Numri i kontratës	Titulli i kontratës	Përshkrimi i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shënim: Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri _____

Adresa _____

Tel/Faks _____

E-mail _____

Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____

E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit : _____

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: _____

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër : _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit: _____

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: _____

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): _____

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

Dhe afati i ri (nëse është rasti): _____

14. Emri dhe adresa e Operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri _____

NIPT: _____

Adresa _____

Kontaktet _____

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : _____

16. Burimi i financimit: _____

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor _____

DOKUMENTAT E TENDERIT

Përmbajtja:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit të Kontratës.

Seksioni II: Shtojcat

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilat duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, sasia dhe grafiku i lëvrimit.

Seksioni III. Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Seksioni III përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e Sigurimit të Kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

Seksioni IV: Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

A. TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i prokurimit

1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.
2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).

2. Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm

- a) "Operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

- 1.1. të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;

- 1.2. BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

- b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës.

3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

**4. Ndryshimi i
Dokumenteve të
Tenderit**

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.
2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë siç është bërë publikimi i Dokumenteve të Tenderit.
